



ZBATIMI I POLITIKAVE MIQËSORE PËR FAMILJEN DHE BARAZINË GJINORE NË SEKTORIN PUBLIK DHE PRIVAT

PERSPEKTIVA TË PUNONJËSVE

Metodologjia


Ky studim synon të kuptojë situatën aktuale, sfidat dhe problematikat e zbatimit të politikave miqësore për familjen dhe barazinë gjinore, duke ofruar rekomandime për të përmirësuar situatën në të ardhmen.

Për realizimin e studimit u aplikua një **metodologji e kombinuar**, e cila përfshiu intervista të strukturuar me rreth 700 punonjës të sektorit privat e publik në të gjithë vendin; rreth 200 intervista me biznese në nivel kombëtar, grupe diskutimi me gratë e papuna e me fëmijë të vegjël; intervista të thelluara me bizneset si dhe me institucionet qeveritare qendrore e lokale. Mbledhja e të dhënave u realizua gjatë periudhës dhjetor 2021- janar 2022. Gjetjet e këtij studimi janë përfaqësuese **në nivel kombëtar**.

Puna në ditët e pushimit dhe ditët e festave

1.


Gjetjet tregojnë se **të punësuarit në sektorin privat punojnë mesatarisht më shumë orë në javë në krahasim me punonjësit në sektorin publik.**
Gjetjet janë të ngjashme dhe për punën në ditët e pushimit javor dhe të festave zyrtare, ku të punësuarit në privat kanë më shumë gjasa të punojnë ditët e shtuna, të diela si dhe në ditë festash.



Fleksibiliteti në orarin e punës

2.

Oraret fleksibël të punës tregojnë se sektori privat ofron më shumë mundësi se ai publik, dhe pse **të dy sektorët janë ende të ngurtë në ofrimin e orareve fleksibël për punonjësit e tyre.**
Pothuaj një në tre punonjës në sektorin privat ka një lloj fleksibiliteti gjatë orarit të punës, kundrejt vetëm 7% të punonjësve në sektorin publik.



Leja vjetore

28 ditë kalendarike për punonjësit në sektorin publik

15 ditë kalendarike për punonjësit në sektorin privat

3.

Të dhënat për aksesin në lejet vjetore nxorën në pah se **të punësuarit në sektorin publik, kanë akses dhe mundësi të plotë për ta përvetësuar lejen e pushimeve vjetore,** ndryshe nga të punësuarit në sektorin privat ku 29% kanë deklaruar se nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga leja vjetore.



Leja e lindjes

4.





Gruaja mbetet prindi kryesor që shfrytëzon të drejtën e lejes së lindjes në vendin tonë.

Të dhënat tregojnë se vetëm

3% e burrave deklarojnë se kanë marrë lejen e lindjes


Aksesi në hapësirat e përbashkëta për pushim, socializim dhe ushqim



5. Gjetjet e studimit reflektojnë **diferenca të konsiderueshme midis sektorit privat dhe atij publik për sa i përket ofrimit të ambienteve për socializim apo konsumim të vakteve.** Një diferencë shqetësuese për gjithë punonjësit e administratës shtetërore që jo vetëm nuk kanë ambiente të dedikuara, por nuk kanë të parashikuar një orar pushimi për konsumimin e drekës.

Ndërkohë të dy sektorët mbeten shumë prapa për ofrimin e shërbimeve të tjera si ambiente të dedikuara për gjidhënie apo në ofrimin e ambienteve për mbajtjen e fëmijëve.

Perceptim i përgjithshëm për krijimin e familjes







e të punësuarve, pavarësisht sektorit, moshës ose gjinisë, e perceptojnë si **shumë të vështirë rritjen e një fëmije** në Shqipëri, kryesisht e lidhur me faktorët ekonomikë.

6.

Prindërimi do të vështirësonte **gjetjen ose mbajtjen** e një pune

Prindërimi do të ndikonte në **humbjen** e vendit të punës



Prindërimi do të vështirësonte **avancimin në karrierë**




Ekulibri punë - familje

Gratë dhe burrat i përjetojnë në mënyra të ndryshme situatat në punë dhe shtëpi. **Gratë i përjetojnë më shumë situatat stresuese të punës** duke i marrë me vete në shtëpi sesa anasjelltas.

7.




e grave i konsiderojnë miqësore për familjen vendet e punës në Shqipëri.



e burrave i konsiderojnë miqësore për familjen vendet e punës në Shqipëri.

Niveli i informimit për politikat miqësore me familjen nga punëdhënësi


Punonjës në sektorin publik



Vihet re se punëdhënësit në sektorin publik i informojnë më shumë punonjësit për politikat miqësore me familjen dhe ato të përgjegjshme gjinore


8.

Në këto kushte duhet bërë më shumë për të rritur nivelin e informimit të punonjësve rreth këtyre politikave në përgjithësi, me fokus të veçantë punonjësit në sektorin privat.



Interesi për politikat miqësore me familjen si dhe politikat e përgjegjshme gjinore

9.



Pjesa më e madhe e punonjësve shfaqin një nivel të lartë interesi për tu informuar për përmbajtjen e këtyre politikave. Punonjëset gra dhe ata më të rinj duket se janë më të interesuar për t'u informuar më shumë për çështje të tilla.